

AKT THEMELIMI

I Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar

“TerraMed ” SH.P.K

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

1. Sot, më 12 Shkurt 2024, unë, themeluesi, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin TerraMed SH.P.K.
2. Themelues i shoqërisë është:

Elvana Tivari, lindur me 11.04.1978, ne Durres, Shqiperi, mbajtëse e pasaportës shqiptare me nr.ID H85411166E.

Neni 2:

Objekti

1. Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë, do të jetë kryesisht i fokusuar ne aktivitetet e mëposhtme, por pa u kufizuar vetëm në to dhe mund të jetë cdo aktivitet i lejuar nga ligji, që përfshin:

- Import-eksport dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të produkteve farmaceutike, kozmetike, bimëve medicinale, shtesa ushqimore dhe dietike, instrumentave, materialeve dhe pajisjeve mjekësore, materialeve me përdorim laboratorik, kite reagentë dhe materiale konsumi laboratorik dhe pajisje laboratorike.
- Montim, mirëmbajtje dhe riparim i aparaturave dhe paisjeve mjekësore, si dhe aksesorëve të tyre, etj.
- Konsulenca të ndryshme në fushën e shëndetësise e mjekësisë që përfshijnë por pa u kufizuar vetëm në to: konsulenca menaxhimi, zhvillimi të biznesit, rregullatore, studime të tregut, marketing etj.
- Shoqëria mund të kryej cdo aktivitet tjeter i cili nuk është i ndaluar nga legjislationi në fuqi, që lidhet direkt apo indirekt me aktivitetet e mësipërme, që është rezultat, parakusht, ndihmës ose që i paraprin atyre.

Neni 3

Kohëzgjatja

1. Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pakufizuar, duke filluar nga Data e Themelimit.

Neni 4

Selia

1. Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën Rruga Sulhaxhi, Muçaj, Vore, Zona kadastrale 2726, Nr. Pasurie 137/52, Tirane.
2. Shoqëria mund ta ndryshojë adresën në një vend apo edhe qytet tjetër brenda Shqipërisë.
3. Shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Neni 5

Kapitali themeltar

1. Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 4.000.000 (kater milion) Leke, i perberë nga 1 (një) kuote me vlerë nominale 4.000.000 (kater milion) Leke. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
 - a. Ortaku themelues Elvana Tivari: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 4.000.000 (kater milion) Leke, që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë;
2. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)
3. Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.
4. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
5. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
6. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 6

Organet e shoqerise

1. Organet drejtuese te shoqerise "TerraMed" sh.p.k jane:
 - Asambleja e Ortakeve, organi me i larte vendimmarres.
 - Administratori i Shoqerise
 - Administrator i pare i Shoqerise caktohet Znj. Elvana Tivari, me afat emerimi 5 vjet.



Neni 7

Organizimi i shoqerise, marredheniet me persona fizike e juridike, vendas apo te huaj, shprehen ne Statut, qe bashke me aktin themelimit jane dokumentat baze te veprimtarise dhe sherbejne per zhvillimin e marredhenieve ne kete shoqeri.

Neni 8

Veprimtarine saj, shoqeria do te zhvilloje ne perputhje me legjislacioni Shqiptar.


Neni 9

Te gjitha mosmarrveshjet me persona fizike ose juridik si dhe me organet shteterore zgjidhen me mirekuptim, me ane te dispozitave te ketij akti, Statutit si dhe legjislacioni shqipetar dhe kur keto mjete nuk jepin rezultat atehere zgjidhen me gjykate.

Tirane me, 12/02/2024

ORTAKET I VETEM

Elvana Tivari

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Elvana Tivari" above a stylized, swooping signature.